REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**MINISTRIA E DREJTËSISË**
**KOMITETI SHQIPTAR I BIRËSIMEVE**

# RELACION SHPJEGUES

## 1. LISTË PËRMBAJTJE E RAPORTEVE TË MONITORIMIT PËR PERIUDHËN JANAR-PRILL 2024

- ANEKSI nr.2 "Raporti mbi Ekzekutimin e Buxhetit në nivelin e Programit të Buxhetit"
- ANEKSI nr.2.1 "Shpenzimet e Programit sipas kapitujve"
- ANEKSI nr.3 "Raporti I performances së produkteve të programit"
- ANEKSI nr.3.1 "Raporti performances së produkteve të programit sipas artikujve"
- ANEKSI nr.3.2 "Devijacioni I kostos për njësi në vite"
- ANEKSI nr.4 "Raporti i realizimit të treguesve të performancës të programit"

## 2. HYRJE

Në zbatim të Shtojcës nr.3, të Udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore", paraqesim në mënyrë të përmbledhur procesin e monitorimit të kryer gjatë periudhës Janar-Prill 2024, si në vijim:
Programi Shërbimet për çështjet e birësimeve në përmbushje të politikës së programit të vet ka kryer të gjitha shpenzimet e nevojshme në përputhje me Ligjin Nr.9936, datë 02.06.2016 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin Nr.97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", si dhe udhëzimet plotësuese të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë në zbatim të tij.

EMP me në krye DEMP ka realizuar në mënyrë të vazhdueshme monitorimin e performancës së programit, konkretisht të politikës së programit, si dhe realizimit të shpenzimeve buxhetore në

funksion të saj për të gjithë artikujt kontabël përkatës. Paralelisht është bërë edhe monitorimi i buxhetit dhe nivelit të shpenzimeve në përputhje me produktet e realizuara.

## 3. INFORMACION BUXHETOR I AGREGUAR

Gjatë periudhës raportuese, në zbatim të Ligjit nr 97/2023, "Për buxhetin e vitit 2024" në zbatim të udhëzimit të ministrit të Financave nr.9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" si dhe Udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.1, dt.24.01.2024 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024", janë rialokuar fonde buxhetore brenda programit. Konkretisht:

a. Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.1374 /1 prot, datë 23.02.2024 "Dërgohet transferim fondi për vitin 2024", vlera prej 24.000 lekësh u pakësua nga llogaria ekonomike 602 (Mallra dhe shërbime) dhe shtimi i saj në llogarinë ekonomike 606 (Transferta te buxhete familjare dhe individë). Këto fonde sipas pikës 14, të VKM 673/2020, do të përdoren për kryerjen e pagesës për kompensimin e titullarit të institucionit të telefonisë celulare.

b. Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.1123/1 prot, datë 21.02.2024 "Dërgohet miratimi i detajimit të fondit të veçantë për vitin 2024", dhe shkresën nr.1123/2 prot, datë 26.02.2024 "Miratim limiti" për institucionin tonë është miratuar detajimi I buxhetit për fondin e veçantë prej 100.000 lekë.

c. Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.1284/2 prot, datë 26.02.2024 "Dërgohet detajimi i limitit mujor për shpenzimet kapitale për vitin 2024", për institucionet në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe për institucionin tonë. Për vitin 2024 do të jetë në zbatim projekti M140033 "Blerje pajisje zyre" në vlerën 200.000 lekë.

Numri I punonjësve sipas strukturës së miratuar nga Kryeministri nr.134 Prot. datë 23.11.2021 dhe strukturës së fundit të miratuar nga Kryeministri me kategotitë e ndryshuara nr.227 Prot. datë 15.12.2023, për Intitucionin tonë, për periudhën Janar-Prill 2024 është 9 punonjës së bashku me Kryetarin e KSHB. Në total bashkë me punonjësit mbështetës bëhen 12 punonjës. Për periudhën 11 Dhjetor 2023 deri 13 Mars 2024, pozicioni I Specialistes (Arkiv-Protokoll) Anxhela Bakalli – me kategori page IV-3, është vakant pasi specialistja është me lejë lindje. Gjithashtu pozicioni i Specialist (Jurist) – me kategori page IV-2 ka qënë i paplotësuar për arsye se punonjësja ishte me

raport paaftësie, të paguar nga Instituti I Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për periudhën 13.Dhjetor.2023- 25.Maj.2024. Pas emërimit të përkohshëm nga ana e Departamentit të Administratës Publike të punonjëses që është me lejë lindje, punonjësja zëvëndësuese ka qëndruar në punë për periudhën 13.03.2024 deri 24.04.2024 dhe është larguar me dorëheqje. Pranë Departamentit të Administratës Publike është depozituar kërkesa jonë për zëvëndësimet në pozicionet e lartpërmendura, për të cilat do të vijojë vazhdimi i proçedurës përkatëse nga DAP.

## 4. PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT

Gjatë periudhës Janar- Prill 2024 është monitoruar vazhdimisht buxheti i miratuar dhe në zbatim të ligjit nr.97/2023 "Për buxhetin e vitit 2024", Udhëzimit Plotësues nr.1, datë 24.01.2024 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024", me kërkesë të KSHB, Ministria e Financave dhe Ekonomisë miratoi rialokimin e shumës prej 24.000 lekë nga artikulli 602 (Mallra dhe shërbime) në artikullin 606 (Transferta te buxhete familjare dhe individë). Nga ana tjetër, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka miratuar fondin e veçantë prej 100.000 lekë për vitin 2024.
Realizimi i buxhetit të Institucionit tonë krahasuar me planin vjetor të buxhetit është e shprehur në përqindje 25 %.

Në Aneksin nr.2 paraqiten ekzekutimi I buxhetit në nivel programi sipas klasifikimit ekonomik dhe sipas produkteve të programit buxhetor si më poshtë :

| | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Emri i Grupit | Ministria e Drejtësisë | | | Kodi i grupit | | | | 14 | | | | |
| Emri i | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | | | Kodi i programit | | | | 01160 | | | | |
| EMËRTIME | | Shpenzimet e Programit | | | | | | | | | | |
| | | Viti paraardhës 2023 | | Periudha raportuese | | Periudha raportuese | | eriudha raportuese | Periudha raportuese | | | |
| | | Shpenzime Faktike | Struktura e shpenzimeve në % | Plani Fillestar Vjetor Viti 2024 | Struktura e shpenzimeve në % | Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2024 | Struktura e shpenzimeve në % | Ndryshimi i planit vjetor | Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive | Struktura e shpenzimeve në % | Ndryshimi Vjetor ( Plan - Fakt) | % e realizimit |
| | | (1) | (2) | (3) | (4) | (5) | (6) | 7 (5-3) | (8) | (9) | 10 (5-8) | 11 ( 8/5) |
| Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik | | | | | | | | | | | | |
| Kodi i Programit | Emërtimi | | | | | | | | | | | |
| 600 | Paga | 10,274,886.00 | 28 | 12,410,000 | 28 | 12,410,000 | 28 | 0 | 3,448,515.00 | 28 | 8,961,485 | 28 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 1,698,259.00 | 27 | 2,090,000 | 27 | 2,090,000 | 27 | 0 | 565,870.00 | 27 | 1,524,130 | 27 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 2,801,677.00 | 17 | 3,440,000 | 17 | 3,416,000 | 17 | -24,000 | 591,344.00 | 17 | 2,824,656 | 17 |
| 603 | Subvencione | 0.00 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.00 | 0 | 0 | 0 |
| 604 | Transferta Korente të Brendshme | 0.00 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.00 | 0 | 0 | 0 |
| 605 | Transferta Korente të Huaja | 0.00 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.00 | 0 | 0 | 0 |
| 606 | Trans per Buxh. Fam. & Individ | 74,000.00 | 7 | 0 | 7 | 124,000 | 7 | 124,000 | 8,000.00 | 7 | 116,000 | 7 |
| | **Nëntotali Shpenzime Korente** | **14,848,822.00** | **26** | **17,940,000** | **26** | **18,040,000** | **26** | **100,000** | **4,613,729.00** | **26** | **13,426,271** | **26** |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | 0.00 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.00 | 0 | 0 | 0 |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | 116,700.00 | 0 | 200,000 | 0 | 200,000 | 0 | 0 | 0.00 | 0 | 200,000 | 0 |
| | **Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm** | **116,700.00** | **0** | **200,000** | **0** | **200,000** | **0** | **0** | **0.00** | **0** | **200,000** | **0** |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | 0.00 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.00 | 0 | 0 | 0 |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | 0.00 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.00 | 0 | 0 | 0 |
| | **Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj** | **0.00** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0.00** | **0** | **0** | **0** |
| | **Totali i Shpenzimeve Kapitale** | **116,700.00** | **0** | **200,000** | **0** | **200,000** | **0** | **0** | **0.00** | **0** | **200,000** | **0** |
| | **Totali i Shpenzimeve Buxhetore të Programit** | **14,965,522.00** | **25** | **18,140,000** | **25** | **18,240,000** | **25** | **100,000** | **4,613,729.00** | **25** | **13,626,271** | **25** |
| | **Shpenzime Korente nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 0** | **0.00** | | | | | | | **0.00** | | | |
| | **Shpenzime Kapitale nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 0** | **0.00** | | | | | | | **0.00** | | | |
| | **Totali i Shpenzimeve të Programit** | **14,965,522.00** | | | | | | | **4,613,729.00** | | | |
| Shpenzimet sipas produkteve të programit buxhetor | | | | | | | | | | | | |
| Artikulli | Emërtimi | | | | | | | | | | | |
| | **Totali i Shpenzime Korente** | **14,848,822.00** | **99** | **17,940,000** | **99** | **18,040,000** | **99** | **100,000** | **4,613,729.00** | **100** | **13,426,271** | **26** |
| Kodi i produktit | Emertimi | | | | | | | | | | | |
| 91404AA | Kërkesa për birësim të shqyrtuara | 14,848,822.00 | 99 | 17,940,000 | 99 | 18,040,000 | 99 | 100,000 | 4,613,729.00 | 100 | 13,426,271 | 26 |
| | **Totali Shpenzime për Investime** | **116,700.00** | **1** | **200,000** | **1** | **200,000** | **1** | **0** | **0.00** | **0** | **200,000** | **0** |
| Kodi i produktit | Emertimi | | | | | | | | | | | |
| 18AR302 | Pajisje elektronike të blera | 79,500.00 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.00 | 0 | 0 | 0 |
| M140033 | Paisje per zyra | 37,200.00 | 0 | 200,000 | 1 | 200,000 | 1 | 0 | 0.00 | 0 | 200,000 | 0 |
| | **Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm** | **116,700.00** | **1** | **200,000** | **1** | **200,000** | **1** | **0** | **0.00** | **0** | **200,000** | **0** |
| Kodi i produktit | Emertimi | | | | | | | | | | | |
| | **Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj** | **0.00** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0** | **0.00** | **0** | **0** | **0** |
| Kodi i produktit | Emertimi | | | | | | | | | | | |
| Kodi i produktit | Emertimi | | | | | | | | | | | |
| | **Totali i Shpenzimeve të Programit** | **14,965,522.00** | | **18,140,000** | | **18,240,000** | | **100,000** | **4,613,729.00** | | **13,626,271** | |

Në Aneksin nr.2/1 paraqiten ekzekutimi I buxhetit në nivel programi buxhetor dhe realizimi i artikujve buxhetore në përqindje si më poshtë :

| Kodi i Ministrisë | Kodi i Programit | Emërtimi i Programit | Kodi i Kapitullit | Emërtimi i Kapitullit | Periudha raportuese | Buxheti | Artikujt buxhetore | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | 230 | 231 | 600 | 601 | 602 | 603 | 604 | 605 | 606 | Total |
| | | | | | Periodike /Vjetore | | Shpenzime Kapitale të Patrupëzuara | Shpenzime Kapitale të Trupëzuara | Pagat | Kontrib.e Sigurimeve Shoqërore | Mallra dhe Shërbime | Subveci-net | Të Tjera Transfer.Korrente Brendshme | Transfer.Korrente të Huaja | Transferta për Buxhetet Familiare dhe Individët | Total |
| 14 | 01160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | 01 | Nga Buxheti | 2024 | Plani fillestar | 0 | 200,000 | 12,410,000 | 2,090,000 | 3,440,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 18,140,000 |
| 14 | 01160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | 01 | Nga Buxheti | 2024 | Plani i rishikuar | 0 | 200,000 | 12,410,000 | 2,090,000 | 3,416,000 | 0 | 0 | 0 | 124,000 | 18,240,000 |
| 14 | 01160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | 01 | Nga Buxheti | 2024 | Fakti | 0 | 0 | 3,448,515 | 565,870 | 591,344 | 0 | 0 | 0 | 8,000 | 4,613,729 |
| 14 | 01160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | 01 | Nga Buxheti | 2024 | Angazhime | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 14 | 01160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | | Total | 2024 | Plani fillestar | 0 | 200,000 | 12,410,000 | 2,090,000 | 3,440,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 18,140,000 |
| 14 | 01160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | | Total | 2024 | Plani i rishikuar | 0 | 200,000 | 12,410,000 | 2,090,000 | 3,416,000 | 0 | 0 | 0 | 124,000 | 18,240,000 |
| 14 | 01160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | | Total | 2024 | Fakti | 0 | 0 | 3,448,515 | 565,870 | 591,344 | 0 | 0 | 0 | 8,000 | 4,613,729 |
| 14 | 01160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | | Total | 2024 | Angazhime | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 14 | 01160 | Ndryshimi ne vlere absolute | | | 2024 | | 0 | 200,000 | 8,961,485 | 1,524,130 | 2,824,656 | 0 | 0 | 0 | 116,000 | 13,626,271 |
| 14 | 01160 | Realizimi ne % | | | 2024 | | 0 | 0 | 28 | 27 | 17 | 0 | 0 | 0 | 7 | 25 |

- Diferencat në realizim në llogarinë ekonomike 600 (Paga) dhe 601 (Sigurime shoqërore) ka lindur si rrjedhojë e pozicionit vakant të Specialistes (Arkiv-Protokoll), e cila është me lejë lindje si dhe pozicioni i Specialist (Jurist) – ka qënë i paplotësuar për arsye se punonjësja ka qënë me raport paaftësie, të paguar nga Instituti I Sigurimeve Shoqërore Tiranë.
  Për llogarinë ekonomike **600-601** "Shpenzimet e personelit" fondet buxhetore u realizuan në masën **80%** për periudhën 4-mujore, krahasuar me planin 4-mujor.Plan 4.980.000 lekë/Fakt 4.014.385 lekë.

- Sa i takon llogarisë ekonomike 602 (Mallra dhe shërbime) ka diferenca. Përqindja e realizimit është **50 %** pasi nuk janë realizuar të gjitha procedurat e prokurimit, të parashikuara gjatë 4-mujorit të vitit 2024. Procedurat e prokurimit janë realizuar 4 nga 7 të parashikuara. Nga ana tjetër, edhe fondet e parashikuara për shërbime nga të tretët kanë qënë më të ulëta se mesatarja e llogaritur e tre viteve të fundit. Për zërin honorare, për anëtarët e Këshillit Drejtues, janë realizuar 3 mbledhje nga 4 mbledhje që bëhet parashikimi për mbledhjet nga anëtarët e Këshillit Drejtues.
  Për llogarinë ekonomike **602** "Shpenzimet operative" u realizuan në masën **50%** për periudhën 4-mujore, krahasuar me planin 4-mujor. Plan 1.200.000 lekë/Fakt 599.344 lekë.

- Po ashtu, fondi prej 124.000 lekë miratuar në llogarinë ekonomike 606 (Transferta për buxhete familjare ose individë). Është shpenzuar pjesërisht pasi nuk ka ndodhur ndonjë një rast për realizimin e tij (raste të situatave të vështira, dalje në pension etj), dhe pjesa tjetër e fondit prej 24.000 lekë është përdorur për kompensimin e telefonisë celulare të titullarit të institucionit.

- Për shpenzimet kapitale nuk është realizuar procedura e prokurimit e parashikuar, **0 %** realizimi.
  Për llogarinë ekonomike **231** "Shpenzimet kapitale" nuk është realizuar procedura e prokurimit për periudhën 4-mujore.

**<u>Për periudhën 4-mujore të vitit 2024, fondet janë realizuar 72 %, krahasuar me planin 4-mujor.</u>**

Përqindja e fëmijëvë të birësuar vjen si pasojë :

- Ulja e lindjeve të padëshiruara në shkallë vendi si pasojë e ndërgjegjësimit të planifikimit familjar.
- Projektet pilot për deinstitucionalizimin e fëmijëve të cilat kanë sjellë transformimin e institucioneve në qendra komunitare shërbimesh të përkujdesit për fëmijë .
- Për sa më sipër ka sjellë një numur më të ulët të fëmijëvë pa interesim në Institucionet e përkujdesit social.
  Gjithashtu si pasojë ka më pak kërkesa për deklarim braktisje të fëmijëvë dhe vonesa në shpalljen e deklarimit të braktisur nga Gjykatat e rretheve .
- Ulja e numrit te lindjeve si pasojë e situatës pandemike të viteve 2020-2021.

Konkretisht numri I fëmijëve ne KSHB lidhet drejtpërdrejt me numrin e dosjeve të depozituara.
Numri I fëmijëve të ardhur në KSHB në 2021 është 26 fëmijë

Numri I fëmijëve të ardhur në KSHB në 2022 është 32 fëmijë
Numri I fëmijëve të ardhur në KSHB në 2022 është 19 fëmijë
Birësimet gjate 2022 janë 35 në total nga të cilat janë mbartur edhe femijët e ardhur nga vitet e mëparshme. Për vitin 2023 kanë ardhur 23 fëmijë dhe janë birësuar 22 fëmije.
**Për vitin 2024 janë birësuar 4 fëmije.**

Gjatë periudhës Janar- Prill 2024, programi Shërbimet për çështjet e birësimeve, ka realizuar veprimtarinë e tij duke e mbështetur politikën e programit mbi një qëllim kryesor, konkretisht:

***Qëllimi*** *– Sigurimi dhe monitorimi i fëmijëve të mitur, të shpallur të braktisur me vendim gjykate, të birësuar nga familje shqiptare që jetojnë brenda ose jashtë vendit si dhe nga familje të huaja, duke garantuar dhe respektuar të drejtat e tyre themelore.*
***Ky qëllim është përmbushur në masën 100%***.

Në realizimin e plotë të tij ka ndikuar puna e bërë gjatë periudhës raportuese nga ana e stafit të KSHB, duke mbajtur gjithmonë parasysh dhe garantuar interesin më të lartë të fëmijës. Gjithashtu, është bashkërenduar puna me të gjitha institucionet që operojnë në fushën e birësimit, agjencitë ndërmjetësuese për birësimet ndërvendase si dhe me të gjitha institucionet e përkujdesit social me qëllim realizimin e proceseve birësuese në përputhje me bazën ligjore në fuqi si dhe brenda një kohe sa më të shkurtër të mundshme.
Në funksion të këtij qëllimi, programi ynë ka patur tre objektiva për realizim, si më poshtë:

1. ***Objektivi 1.1*** – Përfundimi me sukses i dhënies për birësim çifteve shqiptare dhe atyre të huaja të 4 fëmijëve gjatë periudhës Janar- Prill 2024. ***Ky objektiv është përmbushur plotësisht.*** Gjatë periudhës raportuese, KSHB ka shqyrtuar brenda afateve ligjore të gjitha kërkesat për birësim.

**2.** ***Objektivi 1.2*** – Blerje pajisje zyre. ***Ky objektiv është në proces realizimi.*** Është në proces kryerja e procedures për blerjen e pajisjeve të zyrës si dhe do të merret në dorëzim - konkretisht janë duke u blerë dy kondicionerë.

Sipas Anekseve nr.3 Raporti I performances së produkteve të programit dhe nr.3/1 Raporti performances së produkteve të programit sipas artikujve si më poshtë :

| Periudha e Raportimit 4-2024 | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | | | | | | | | | | në/lekë |
| Emri i Grupit | Ministria e Drejtësisë | | Kodi i grupit | | | | | 14 | | | | | | | | | |
| Emri i | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | | Kodi i programit | | | | | 01160 | | | | | | | | | |
| | | | Viti paraardhës | | | Periudha Rapotuese | | | Periudha Rapotuese | | | Periudha Rapotuese | | | Deviacioni i Kostos për Njësi | | |
| Kodi i Produktit | Emërtimi i Produktit | Njësia matëse | Sasia Faktike (Viti paraardhës) | Shpenzimet Faktike (sipas vitit paraardhes) | Kosto për Njësi (sipas vitit paraardhës) | Sasia (sipas planit Fillestar Vjetor) | Shpenzimet (sipas planit Fillestar Vjetor | Kosto për Njësi (sipas planit Fillestar të vitit | Sasia (sipas planit të rishikuar të vitit korent) | Shpenzimet (sipas /nplanit të rishikuar të vitit korent) | Kosto për Njësi(sipas /nplanit të rishikuar të vitit korent) | Sasia Faktike (në /nfund të vitit korent) | Shpenzimet Faktike /n(në fund të vitit korent) | Kosto për Njësi Faktike n/(në fund të vitit korent) | 13=(12)-(3) | 14=(12)-(6) | 15=(12)-(9) |
| | | | (1) | (2) | (3) | (4) | (5) | (6) | (7) | (8) | (9) | (10) | (11) | (12) | (13) | (14) | (15) |
| Produktet e realizuara me shpenzimet buxhetore të programit | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| 91404AA | Kërkesa për birësim të shqyrtuara | Numër | 22 | 14,848,822 | 674,946 | 25 | 17,940,000 | 717,600 | 20 | 18,040,000 | 902,000 | 4 | 4,613,729 | 1,153,432 | 478,486 | 435,832 | 251,432 |
| M140033 | Paisje per zyra | Numër | 1 | 37,200 | 37,200 | 2 | 200,000 | 100,000 | 2 | 200,000 | 100,000 | | 0 | | | | |
| T | Total | | | 14,965,522 | | | 18,140,000 | | | 18,240,000 | | | 4,613,729 | | | | |
| Produktet e realizuara nga përdorimi i të ardhurave jashtë limitit (Nga kapitulli 06) | | | | | | | | | | | | | | | | | |

| Kodi i Ministrisë | Kodi i Programit | Emërtimi i Programit | Kodi I Produktit | Emërtimi i Produktit | Tipi i Buxhetit | Sasia | Total | Artikujt buxhetore | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | | | 230 | 231 | 600 | 601 | 602 | 603 | 604 | 605 | 606 |
| | | | | | | | | Shpenzime Kapitale të Patrupëzuara | Shpenzime Kapitale të Trupëzuara | Pagat | Kontrib.e Sigurimeve Shoqërore | Mallra dhe Shërbime | Subvenci-net | Të Tjera Transfer.Korrente Brendshme | Transfer. Korrente të Huaja | Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individët |
| 14 | 01160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | 91404AA | Kërkesa për birësim të shqyrtuara | Plani fillestar | 25 | 17,940,000 | 0 | 0 | 12,410,000 | 2,090,000 | 3,440,000 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 14 | 01160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | 91404AA | Kërkesa për birësim të shqyrtuara | Plani i rishikuar | 20 | 18,040,000 | 0 | 0 | 12,410,000 | 2,090,000 | 3,416,000 | 0 | 0 | 0 | 124,000 |
| 14 | 01160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | 91404AA | Kërkesa për birësim të shqyrtuara | Fakti | 4 | 4,613,729 | 0 | 0 | 3,448,515 | 565,870 | 591,344 | 0 | 0 | 0 | 8,000 |
| 14 | 01160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | M140033 | Paisje per zyra | Plani fillestar | 2 | 200,000 | 0 | 200,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 14 | 01160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | M140033 | Paisje per zyra | Plani i rishikuar | 2 | 200,000 | 0 | 200,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 14 | 01160 | Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve | M140033 | Paisje per zyra | Fakti | | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | Totali i shpenzime buxhetore | Plani fillestar | | 18,140,000 | 0 | 200,000 | 12,410,000 | 2,090,000 | 3,440,000 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | | | | Totali i shpenzime buxhetore | Plani i rishikuar | | 18,240,000 | 0 | 200,000 | 12,410,000 | 2,090,000 | 3,416,000 | 0 | 0 | 0 | 124,000 |
| | | | | Totali i shpenzime buxhetore | Fakti | | 4,613,729 | 0 | 0 | 3,448,515 | 565,870 | 591,344 | 0 | 0 | 0 | 8,000 |

Sa i takon realizimit të produkteve për secilin objektiv, situata paraqitet si në vijim:

Objektivi 1.1 Ka patur një produkt të parashikuar:

**Produkti 91404AA** – Kërkesa për birësim të shqyrtuara. ***Ky produkt është përmbushur në masën 60 %*** krahasuar me planin 4-mujor .

| | |
|---|---|
| Sasia (sipas planit 4/mujor) | 7 |
| Sasia (sipas planit të rishikuar 12/mujor) | 20 |
| Sasia faktike (në fund të 4/mujorit të vitit 2024) | 4 |

**Produkti M140033** – Blerje Pajisje zyre. ***Për këtë produkt është në process procedura e prokurimit. Ky produkt nuk është realizuar.***

Birësimet gjate 2022 janë 35 në total nga të cilat janë mbartur edhe femijët e ardhur nga vitet e mëparshme.
*Për vitin 2023 janë birësuar 22 fëmijë.*
***Pë vitin 2024 janë birësuar 4 fëmijë..***

**Qëllimi i KSHB është realizuar në masën 100% pasi janë birësuar të gjithë fëmijet e ardhur për këtë periudhë .**

Shpenzimet për këto produkte janë planifikuar me fondet e miratuara nga Buxheti i Shtetit në fillim të vitit 2024.

Të gjitha procedurat e birësimit të realizuara brenda dhe jashtë vendit kanë rezultuar të sukseshme dhe përshtatja prind-fëmijë është arritur plotësisht.

Po ashtu, të gjithë treguesit e performancës në nivel objektivi janë realizuar.

Në përfundim të analizës së realizimit të qëllimit, objektivave dhe produkteve të programit, mund të themi se gjatë periudhës Janar-Prill 2024, KSHB ka bërë një punë mjaft të mirë për përmbushjen e politikës së programit të vet. Institucioni është angazhuar maksimalisht për vijimin e detyrave të parashikuara, duke përmbushur plotësisht qëllimin dhe objektivin kryesor të KSHB, që është shqyrtimi i të gjitha kërkesave të aplikantëve birësues, si dhe realizimi i proceseve birësuese për të gjithë fëmijët dosjet e të cilëve janë depozituar ne KSHB duke garantuar në çdo rast interesin më të lartë të fëmijëve.

**Theksojmë se, gjatë periudhës Janar- Prill 2024, për institucionin tonë nuk paraqitet asnjë detyrim i prapambetur i krijuar rishtazi apo i mbartur**. Të gjitha shpenzimet janë kryer në kohë dhe janë përballuar me fondet nga Buxheti i Shtetit.

## 5. PROJEKTET KAPITALE

Në përfundim, sqarojmë se, KSHB nuk ka parashikuar dhe realizuar asnjë objekt investimi për projekte të mëdha kapitale me financim brendshëm ose të huaj. Gjithashtu, institucioni nuk siguron të ardhura jashtë limitit dhe si rrjedhojë nuk ka financuar asnjë shpenzim nga ky burim të ardhurash.

## 6. NDRYSHIMET NË BUXHET

Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.1123/1 prot, datë 21.02.2024 "Dërgohet miratimi i detajimit të fondit të veçantë për vitin 2024", dhe shkresën nr.1123/2 prot, datë 26.02.2024 "Miratim limiti" për institucionin tonë është miratuar detajimi I buxhetit për fondin e veçantë prej 100.000 lekë. Gjithsej janë shtuar fonde prej 100.000 lekësh, në llogarinë si vijon :

- Për llogarinë ekonomike 606: 100.000 lekë

Ndryshimet e buxhetit(shtesat) paraqiten për periudhën raportuese në formë tabele,sipas llogarive ekonomike si në vijim:

Në lekë

| | Totali | Llog. 600 | Llog. 601 | Llog. 602 | Llog. 606 | Llog. 231 |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Buxheti (Plan)** | **18.140.000** | 12.410.000 | 2.090.000 | 3.440.000 | | 200.000 |
| **Buxheti (shtesat në plan)** | **100.000** | | | | 124.000 | |
| **Nryshimet në buxhet(shtesat)** | **18.240.000** | **12.410.000** | **2.090.000** | **3.416.000** | **124.000** | **200.000** |
| **Plan thesari 4-mujor** | **6.380.000** | **4.980.000** | | **1.200.000** | | **200.000** |
| **Realizimi fakt** | **4.613.729** | **3.448.515** | **565.870** | **591.344** | **8,000** | |

Realizimi I buxhetit të Institucionit tonë për periudhën Janar- Prill 2024 është 4,613,729 lekë, krahasuar me buxhetin total të vitit 18.240.000 lekë, e shprehur në përqindje është 25%.

## 7. PËRFUNDIME

**Përqindja e realizimit të buxhetit për periudhën raportuese është në masen 25 %.**
Të ardhurat sekondare të sigururara nga tarifat e birësimit gjatë periudhës Janar- Prill 2024 janë derdhur 100% në Buxhetin e Shtetit. Të ardhurat e Institucionit tonë për periudhën 4-mujore janë 534.480 lekë.
Gjatë periudhës Janar- Prill 2024, institucioni ynë, në kuadër të monitorimit të buxhetit, ka përgatitur në Evidencën e shpenzimeve përkatëse.

| | |
|---|---|
| **HARTOI:** | **MIRATOI:** |
| **SPECIALIST (BUXHET - FINANCË)** | **KRYETAR** |
| **Elda Liçkollari** | **Alma Laci** |